



---

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 16**

**Datë: 08. 02. 2021. Ora: 14:00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Aktivitetet e ZRPPC-së**

**Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhguesve**

- 3. Raport i Këshillave të KQZ-së**

**Këshilli për Operacione Zgjedhore**

**Shqyrtimi i nominimeve rreth përbërjes së KVV-ve për ekipet mobile, sipas komunave përkatëse, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021,**

**4. Këshilli për Buxhet dhe Financa**

**Shqyrtimi i Vendimit për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV), për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021**

## **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbushjet e telefonisë mobile, për zgjedhjet e parakohëshme për Kuvendin e Kosovës 2021**

### **5. Këshilli për Informim Publik**

#### **Informatë rreth aktiviteteve të Informimit Publik**

### **6. Të ndryshme.**

---

#### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Përshëndetje të gjithëve e hapim mbledhjen e 16 të KQZ-s. A ka dikush vërejtje në rend dite? Kush është për këtë rend dite? Fillojmë me aktivitetet e SKQZ-s

#### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-s**

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati është në procesin e përgatitjeve të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Aktualisht është duke u punuar në shumë dimensione me qëllim të përgatitjes për zgjedhje. Aktualisht ajo që ndërlidhem me votimin prej postës, kemi zhvilluar komunikime dhe tani e kemi edhe procedurën se si do ti pranojmë të gjitha votat, zarfet apo pakot që vijnë përmes postës. Po ashtu edhe përmes postave kurriere që janë posta të shpejta, të njëjtën procedurë do ta aplikojmë sikurse në postën qendrore po ashtu edhe në posta të shpejta. Të shtunën i kemi marr diku rreth 3,000 zarfe apo pako prej votimit përmes postës nga posta e shpejt DHL. Pra ky është kontingjenti i par që kemi marr me datën 6 shkurt ku kanë qenë 2,776 pako me fletëvotime të cilat janë të vendosura në 22 thasë me mbishkrimin e DHL-s. Pra është bërë sipas procedurës ku e kemi personin e autorizuar nga KQZ-ja për ti pranuar, sigurisht se është bërë me përcjellje të Policisë dhe nën vëzhgimin e vëzhguesve. Ndërsa pjesët e tjera të aktiviteteve ndërlidhen me nga ditët në funksion të organizimit të zgjedhjeve po ashtu jemi në fazën e furnizimeve dhe shërbimeve për të kryer këto aktivitete. Pra me 8 shkurt ka filluar shtypja e listave përfundimtare të votuesve, lidhur me këtë aktivitet do të shtypen 1,200 lista komunale të votuesve për qendrat e numërimit dhe tavolina ndihmëse, si dhe 2,382 lista përfundimtare të votuesve.

Në këtë fazë, tha z. Ahmetaj, jemi duke bërë trajnime të KVV-e në disa komuna për shkak të agjendave të ndryshme, sidomos në shkollat në komuna që janë të mëdha trajnimi ka filluar ditën e diele, praktikisht ditën e djeshme ka filluar trajnimi sidomos në komuna të mëdha që janë, Prishtina, Prizreni, Podujeva dhe Gjakova. Ndërsa komunat e tjera sot kanë filluar trajnimi i KVV-e, janë furnizuar me pako të trajnimit si dhe me doracak me qëllim që të zhvillohet trajnimi për KVV-t. Pavarësisht kësaj jemi duke u përgatitur ta bëjmë trajnimin e stafit që do të punoj në shërbimin votues për kategorizimin e zarfeve që vijnë përmes postës, procedurë e cila fillon nga dita e zgjedhjeve tutje e deri në përgatitjen e këtyre zarfeve pra ndarja

e tyre. Po ashtu edhe trajnimi i stafit të rezultuarve preliminare ka filluar sot i cili parashihet të përfundoj ditën e mërkure dhe pastaj do të filloj edhe trajnimi i stafit të QNR-s. Pra aktualisht jemi në fazën e trajnimeve të gjitha trupave zgjedhor me qëllim të organizimit të zgjedhjeve. Krahas kësaj janë bërë edhe gjitha përgatitjet për ti furnizuar me materiale furnizuese dhe me shërbime të tjera, janë shpërndarë kabinat e votimit, kutit dhe materialet e tjera fillestare që janë shpërndarë deri më tani dhe sipas informacioneve që kemi sa i përket fletëvotimeve pritet që fletëvotimet të arrijnë diku nga dita e premte në Kosovë, jemi në procesin e shtypjes së fletëvotimeve. Për dallim nga zgjedhjet e fundit nuk kemi pasur mundësi të shkojmë e ti shohim shtypjen e fletëvotimeve nga afër për shkaqe pandemike, ka qenë e pa mundur që të sigurohet pasi që të gjitha hotelet kanë qenë të mbyllura. Pra kjo ka qenë arsyeja pse nuk kemi mundur të shohim nga afër printimit e fletëvotimeve. Ndërsa aktivitetet e tjera janë në rrjedha normale po ashtu spejat i kemi të siguruar dhe materialet e tjera janë në proces e sipër, pra kaq në pika të shkurtra sa i përket përgatitjeve për procesin zgjedhor në kuadër të organizimit. Nëse keni pyetje mund të përgjigjem.

**Alim Rama:** Në planin e punës dhe vendimin që kemi marr të premtën kemi kërkuar që të informoni postën edhe QTP-n. Unë sot nuk e pash në raport dhe nuk e morra njoftimin që sekretariati shkon ti merr në ora 14:00 apo 15:00 siç e kemi caktuar dhe në QTP. Ku është problemi? Ajo ka qenë kërkesa që u aprovua të premtën. Ndërkohë po ashtu unë ua dërgova një e-mail nuk morra asnjë konfirmim që të njoftohet QTP-ja dhe posta për pranimin e vëzhguesve sipas listës siç janë akredituar.

**Burim Ahmetaj:** Sot e kemi plan të shkojmë tek të gjitha postat që na kanë konfirmuar se do të marrim dërgesa. Kompania DHL na ka njoftuar se sot nuk mundet ta bëjë pranimin e zarfeve për shkak që janë në procesin e përgatitjes dhe nesër do të bëhet marrja e tyre në DHL. Ndërsa në postat e tjera na kanë konfirmuar se është një numër i vogël, po ashtu edhe në postën qendrore është një numër shumë i vogël i zarfeve të cilat kanë arritur dhe nevojitet të merren. Ndërsa sa i përket QTP-s jemi në procesin e komunikimit për procedurat që do ti zhvillojmë. Pra sigurisht se do ta kemi konfirmimin në mënyrë verbale me ta.

**Alim Rama:** Vendimi është marr të premtën. Ky komision e ka votuar vendimin të shkoj në QTP dhe në postën numër 6. Kur LVV-ja i ka dërguar vëzhguesit në postën numër 6 i kanë refuzuar dhe kanë thënë se nuk janë të njoftuar, në parim ju besoj atje. Kështu që unë dërgova listë, ZRPP-ja konfirmoj se ata kanë qenë vëzhgues të certifikuar. Unë nuk e kuptoj pse nuk kanë shkuar letra në post. As postës as një instucion nuk ka drejt sepse janë votat e të gjithë qytetarëve dhe ata kanë plotësisht të drejt. Secili vëzhgues i akredituar, unë i ftoj edhe subjektet e tjera që ti dërgojnë vëzhguesit që ta caktojnë hapësirën brenda për brenda dhe posta duhet të kuptoj që është në shërbim të qytetarëve. Nuk ka as verbal, as këto, vendimi është marr të premtën. Këtë neglizhencë nuk mundem ta kuptoj nga sekretariati kurrsesi. Nga e premtja edhe unë jam i informuar se ka një sasi të konsiderueshme të pakove edhe në QTP që unë besoj se ka ende kohë, duhet ti njoftojmë menjëherë që ekipi të shkoj e ti merr siç ka qenë orari aty. Nuk i takon as sekretariatit as askujt cilën ditë ti dërgojmë e cilën jo. Në çoftë se themi nesër vjen posta ditën tjetër i kemi tërheq, të shtunën në mëngjes. Kështu që nuk është e mjaftueshme duke marr parasysht që në QTP, KQZ-ja nuk i ka tërhequr ende zarfet. Kisha lutur që urgjentisht kjo punë të kryhet dhe të dërgohet lista e vëzhguesve sepse vëzhguesit e LVV-s po presin para dyerve atje dhe për shkak të neglizhencës kjo është e pa tolerueshme. Po ashtu po vërej një neglizhencë në disa procese të tenderimit, ishte një shkrim mbrëmë në KOHA DITORE ju kisha lut ta verifikoni çka është problem. Po ashtu sot jemi njoftuar që tenderi për shtypjen e begjave nuk është përfunduar, ju lutem të na konfirmon çështjen bazike të këtij dhe pse.

Nuk po e kuptoj për një proces të një institucioni i cili organizon zgjedhje në këtë kohën e fundit të ketë problem të shkoj në ri tenderim për shkak të specifikave kjo po më duket totalisht e pa arsyeshme.

**Burim Ahmetaj:** Sa i përket QTP-s jemi në pjesën e komunikimit dhe do të finalizohet sot. Sigurisht se do të kenë mundësi dhe qasje nga ajo që është vendosur në KQZ. Ndërsa sa i përket distinktivëve që është në ri tenderim specifikat kanë qenë ato që kanë qenë të njëjta po thuajse me zgjedhjet e fundit dhe ato të 2019-tës. Mirëpo operatorët në fazën e par që është anuluar tenderi nuk janë përmbajtur asaj çka është kërkuar. Komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk janë përmbajtur specifikave dhe për këtë arsye është anuluar. Është dashur të shpallet ri tenderimi, sot jemi në fazën kur duhet të presim deri në ora 18:00 në mënyrë që të bëhet informimi publik që nesër ta kemi edhe kontratën për printimin e distktivin dhe më pas ta vazhdojmë printimin e distinktivëve për trupat zgjedhor dhe gjithë stafin që angazhohet ne procesin e zgjedhjeve. Ndërsa për pjesën tjetër nuk jam në dijeni.

**Sami Kurteshi:** Pika e 8 e raportit është kjo për personat me Covid. Unë e kam një mesazh që një familjar i është shpallur këto dit me Covid ata me gjasë nuk kanë mundur të lajmërohen tek ekipet mobile, e tërë familja nuk mundet të lajmohet. Si do të veprohet me këta njerëz? A i lajmon IKSHP-ja KKZ-n, KKZ-ja merr. Cilat janë veprimet që ata njerëz ta kuptojnë që do të votojnë. Po janë me një gjendje që jo me dëshirën e tyre nëse mund ta sqaroni është në pyetje një familje që nuk kanë të drejt të dalin komplet.

**Burim Ahmetaj:** E kemi praktikën e zgjedhjeve për kryetar komune për Podujevë dhe në Mitrovicën e Veriut, ku zyrtarët tan komunal kanë komunikuar direkt me shtabet lokale sepse fillimisht ka qenë kërkesa me institutin por praktika na ka treguar se me shtabet komunale të komunikojmë dhe tash të gjithë zyrtarët komunal janë në komunikim të ngushtë me shtabet lokale emergjente në mënyrë që ti identifikojmë të gjithë personat e ngujuar për shkak të infektimit me Covid që shpresojmë ti kenë listat e kësaj familje në mënyrë që të identifikohet dhe kjo familje dhe ti ofrojmë mundësinë që të votojnë përmes ekipeve mobile. Ndoshta për të qenë më të shpejt kishte qenë mirë të dimë për cilën komunë dhe nëse kemi informacione ta dimë pas mbledhjes. Apo duhet ta lëmë të kryejnë zyrtarët komunal punën e vet së bashku me shtabet komunale emergjente në mënyrë që të identifikohen të gjithë personat e ngujuar që t`ju mundësohet të gjithëve të votojnë përmes ekipeve mobile. Pra personat që janë të ngujuar shkak i infektimit.

### **3.Aktivitetet e ZRPPC-së**

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhguesve**

**Ylli Buleshkaj:** Të nderuar anëtar para jush e keni listën me rekomandimet për akreditim të vëzhguesve nuk e di a të lexojmë një nga një...! Pra, kemi para jush akreditimin e 5,811 vëzhguesve të LDK-s, pastaj është AAK-ja me 4,755, LVV-ja me 5,519, PDAK me 86 vëzhgues, 120 vëzhgues të PAI, 38 vëzhgues nga NASHA, 57 vëzhgues nga Adriana Hoxhiq, 86 vëzhgues nga PLE, 170 për LB, 81 nga JGP, 57 nga RI, 7 nga IQ ZSP, 26 nga koalicioni Za Jedno, 46 nga Parteshka OJQ, 51 vëzhgues shtesë nga IPD, kemi 3 vëzhgues nga media ndërkombëtare Radio televizioni Vojvodina, kemi 6 vëzhgues nga Radio Kosova 2 nga komunitetet, kemi 16 vëzhgues nga media Kanal 10, kemi 19 vëzhgues nga Radio Kosova, 3 vëzhgues nga media ndërkombëtare TRT Worlds, kemi 1 vëzhgues nga radio televizioni i Sllovenisë, 7 vëzhgues nga West Foundation organizatë ndërkombëtare, 4 vëzhgues nga Ambasada e Turqisë në Prishtinë, 2 vëzhgues nga Konsullata e Republikës së Turqisë në Prishtinë kemi 1 vëzhgues nga Ambasada e Kroacisë në Kosovë, 11

vëzhgues nga Ambasada e Francës, 12 vëzhgues nga Ambasada Britanike, 3 vëzhgues nga Ambasada e Hungarisë, 6 vëzhgues nga Ambasada e Suedisë, 3 vëzhgues nga Ambasada e Republikës Çeke, 4 vëzhgues nga Ambasada e Japonisë e cila ka zyre ndërlidhëse në Kosovë, 2 nga Ambasada e Bullgarisë, 2 vëzhgues nga Ambasada e Italisë dhe 25 vëzhgues nga Zyre e Unionit Evropian në Kosovë. Deri më tani janë afro 19,000 vëzhgues. Tash jemi në shqyrtimin e vëzhguesve nga jashtë por, ka edhe nga partitë e madha...

Anwtarwt e KQZ-sw, miratuan kwto rekomandime pwr akreditim tw vwzhguesve.

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me raportin e këshillave. Këshilli i KOZ-it....!

#### **4.Raport i Këshillave të KQZ-së**

##### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

Shqyrtimi i nominimeve rreth përbërjes së KVV-ve për ekipet mobile, sipas komunave përkatëse, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021:

**Alim Rama:** Në KOZ për të bërë shqyrtimin e KVV-e për ekipet mobile sipas komunave, tabelën e keni të bashkangjitur për zgjedhjet. KOZ-i në mënyrë unanime rekomandon KQZ-n për aprovim të numrit të ekipeve mobile dhe i ka kërkuar sekretariatit që të sigurohet që të gjitha këto ekipe mobile kanë për të qenë në gjendje ti kryejnë këto shërbime në ditën e zgjedhjeve për të gjithë ata që janë të ngujuar me Covid. Dhe përdorimi i rezervave nëse është nevoja.

**Valdete Daka:** Kush është për? Miratohet. Pra, do të jenë gjithsej 200 ekipe mobile.

**Alim Rama:** Për shkak të paparashikueshmes të Covidit të jenë në gjendje ti shërbejnë të gjithë qytetarët. Po ashtu në mbledhjen e sotme KOZ-i ka bërë shqyrtimin e kërkesës së KKZ-s së Prizrenit për rialokimin e qendrës së votimit nga objekti i shkollës në objektin e ambulantes i cili është në një hapësirë që ka të bëjë me hapësirën e qendrës së votimit 2059A në fshatin Posliq për shkak të kushteve teknike shkolla është në rinovim dhe rinovimi nuk ka shkuar sipas planit.

**Valdete Daka:** Votuesit nga vendvotimi 2059A, tw rialokohen në ambulantw, në oborr të shkollës. Vazhdojmë me pikën tjetër këshilli për buxhet dhe financa.

#### **5.Këshilli për Buxhet dhe Financa**

1.Shqyrtimi i Vendimit për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV), për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021:

**Sami Hamiti:** Sot në mbledhjen e 5 të këshillit për buxhet kemi shqyrtuar dy pika të rendit të ditës. Shqyrtimi dhe miratimi për pagesat e stafit të angazhuar në qendrat e votimit për zgjedhjet e parakohshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ne e kemi analizuar këto projeksione, oferta që kanë ardhur nga sekretariati janë shuma të cilat edhe në dy zgjedhjet e kaluara edhe nacionale edhe ato lokale, shumat nuk kanë ndryshuar janë në bazë te projeksionit të buxhetit të aprovuar të 14 shkurtit. Duhet t`ju njoftoj që përveç që pas pastrimit të listës zgjedhore dhe zvogëlimit të vendvotimeve rrjedhimisht është

zvogëluar edhe numri i stafit nëpër vendvotime diku 1,500 është kursim i asaj cka është planifikuar nga projekcioni i par sepse është pastruar lista zgjedhore dhe janë zvogëluar vendvotimet kështu që për 1,500 vet më pak është zvogëluar dhe rrjedhimisht i bie të harxhohet më pak. Janë të gjitha në projeksione buxhetore ashtu siç e kemi planifikuar dhe shumat nuk kanë ndryshuar nga zgjedhjet e kaluara. Unanimisht e kemi votuar.

**Valdete Daka:** Kush është për? Miratohet.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për mbushjet e telefonisë mobile, për zgjedhjet e parakohëshme për Kuvendin e Kosovës 2021:

**Sami Hamiti:** Pika tjetër që e kemi shqyrtuar është shpenzimet telefonike për menaxher të qendrave të votimit për ekipet mobile për zgjedhjet e parakohëshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Janë menaxherët e qendrave të votimit që janë 888 dhe ekipet mobile që janë 200 pjesa tjetër është për mbushjet të cilat janë shfrytëzuar për listën votuese jashtë vendit. Edhe këtë pikë e kemi votuar unanimisht në Këshillin për Buxhet.

**Valdete Daka:** Kush është për? Miratohet.

## **6.Këshilli për Informim Publik**

### **Informatë rreth aktiviteteve të Informimit Publik**

**Arianit Elshani:** Këshilli për Informim Publik gjatë datave 4 deri me 6 shkurt 2021, ka mbajtur mbledhjet e Këshillit për Informim Publik ku ka shqyrtuar dizajnimin e posterave pastaj video spotet dhe publikime e tjera edhe në rrjete sociale edhe nëpër media televizive. Gjatë kësaj kohe zakonisht kemi pasur vetëm video spote si të plotësohet fletëvotimi dhe informatat për votimin me post. Ndryshe nga herët e tjera po besoj që është një paraqitje më e mirë në raport me rrjetet sociale të Facebook-ut që bëhen në lidhje edhe të dizajnit por edhe të informatave që publikohen nga KQZ-ja, diçka më shumë nuk kam.

**Alim Rama:** Pres një pyetje nga kryeshefi, kur bëhet konfirmimi për të shkuar në QTP ?

**Burim Ahmetaj:** Stafi, është duke përgatitur shkresën dhe posa ta kryejmë konfirmimin do ju njoftojmë.

**Alim Rama:** Duhet informata që sot vëzhguesit ti dërgojmë dhe nuk e kuptova këtë neglizhencë nga e premtja por ne punojmë edhe të shtunë e të dielën kemi pasur mbledhje.

**Burim Ahmetaj:** Do ju njoftojmë së shpejti me shkrim...

**Sami Kurteshi:** Nuk e di për anëtar të tjerë por, tek ne vazhdojnë të vijnë mesazhe, e-maile që kanë votuar nga jashtë ku nuk ju kthehen ankesat apo nuk ju përgjigjen fare Z. Kryeshef. Një pyetje kam konkrete. Kur është publikuar lista e votuesve jashtë vendit në ora sa. Sepse ju kthehet përgjigje negative në ora 19:00 janë bërë 24 orë nga publikimi i listës për arsye formale ju kthehet përgjigje negative dhe ju refuzohet e drejta. A bën të na tregosh sepse ne atë ditë e kemi filluar mbledhjen me vonesë, vendimin e kemi marr me vonesë. Unë e di që pas orës 20:00 dhe kjo është krejt e pa drejt t`ju kthehet për arsye formale rreth gjysmë ore një orë ka luajtur t`ju refuzohet kërkesa. A bën ta dimë publikisht në ora sa sekretariati e ka hapur apo e ka publikuar listën ku njerëzit kanë mundur ta shohin dhe pastaj të reagojnë dhe ankohen.

**Burim Ahmetaj:** Duhet ta shohim nga sekretariati dhe shërbimi saktësisht se në ora sa dhe në mbledhjen e radhës do ju njoftojmë se kur saktësisht është publikuar. Mirëpo unë konsideroj se diku rreth orës 19:00-20:00 ka qenë publikimi në ueb-faqe. Ndërsa, vendimi është marr nga KQZ-ja. Duhet t`ju referohemi shërbimit dhe na tregoj me saktësi. Do ju njoftojmë me e-mail.

**Alim Rama:** Sekretariati duhet të na tregoj kur ka dalë publike. Problemi i PZAP-it është se gjatë gjithë ditës ka marr e-maile deri kur ka dalë në ora 16:00 ka thënë nuk pranojmë më e-maile dhe ky është një absurd i PZAP-it. Çoftë se ata mendojnë se votën e drejt me dezinformim është një send shumë i madh...